



Programi i Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë EUKOJUST

Thirrje për shprehje të interesit për Ekspertë Vendorë Afatmesëm

Projekti EUKOJUST ka identifikuar nevojën për tre Ekspertë Vendorë Afatmesëm si vijon:

- Lot 1: Ekspert Vendor Afatmesëm 1 Ekspert i legjislacionit
- Lot 2: Ekspert Vendor Afatmesëm 4 Ekspert për TIK
- Lot 3: Ekspert Vendor Afatmesëm 5 për TIK në Gjykatore

Tenderi është i ndarë në tre Lote. Ftohen kandidatët e interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojnë Shprehjen e Interesit të tyre për t'u përfshirë në procedurën e interesit nëse konsiderohet e përshtatshme. Numri i Loteve me të cilën mund të shpërblehet një ofertues është vetëm një.

Historiku i projektit

Objektiva e përgjithshme e Grantit të BE -së: Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: EUKOJUST), i cili zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), është **reformimi i sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.**

Objektivat specifike të projektit janë:

- Forcimi i kapaciteteve dhe koordinimi ndërinstitucional në sektorin e drejtësisë në përputhje me Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe Strategjinë që po zhvillohet
- Forcimi i pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies, profesionalizmit, cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së gjyqësorit
- Konsolidimi i mëtejshëm dhe bashkërendimi i kornizës ligjore dhe institucionale me legjislacionin, standardet dhe praktikat evropiane si dhe përmirësimi i zbatimit të ligjeve
- Përmirësimi i qasjes në drejtësi, veçanërisht për gratë dhe grupet e pafavorshme ose të marginalizuara

Procedura e tenderimit

Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në procedurën e tenderit inkurajohen të dorëzojnë letrën e tyre të interesit deri më **6 prill 2022** në gjuhën angleze me e-mail në kosovo@irz-projects.de.

E-maili duhet t'i referohet numrit të Lotit dhe titullit të detyrës duke dërguar një letër motivimi dhe një CV të



shkurtër (maksimumi 2 faqe për të dyja). Referencat duhet të jenë të disponueshme sipas kërkesës. Për t'u konsideruar të përshtatshëm kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale të përmendura më poshtë.

Kandidatët që konsiderohen më të përshtatshëm do të ftohen të dorëzojnë ofertën e tyre të plotë, të përbërë nga CV, mundësisht në formatin EuropeAid dhe një koncept të shkurtër për shërbimin e ofruar në një dokument (PDF). Kandidatët do të marrin pjesë në një intervistë *online* për të paraqitur ofertat e tyre. Përzgjedhja përfundimtare do të bazohet në kualifikimet e kërkuara dhe në intervistë. Kriteret e vlerësimit do të përcaktohen në detaje në ftesën për tender.

Detyrat do të duhet të miratohen zyrtarisht nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Kosovë, me kusht që të mos ketë asnjë kundërshtim nga përfituesit përkatës.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni në adresën ahmeti@irz.de.

Kërkesat për kualifikim

Për të marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes, në datën e dërgimit të aplikacionit, të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme të pranueshmërisë:

- Nuk jeni dënuar penalisht dhe nuk keni ndonjë masë që ndërlidhet me masat parandaluese, vendimet civile dhe masat administrative të regjistruara në evidencën penale apo ndonjë krim që pengon kontraktimin tuaj me Administratën Publike;
- Nuk jeni nën ndonjë procedurë penale;
- Nuk keni konflikt interesi, si financiar, ekonomik apo personal, i cili mund të perceptohet si komprometues të paanësisë dhe pavarësisë së tij apo saj të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe që mund të rezultojë në një shtrembërim të konkurrencës
- Nuk jeni nëpunës civilë kosovarë.



LOT 1: TR për Ekspert Vendor Afatmesëm 1

Asistenca teknike e kërkuar	Ekspert Vendor Afatmesëm 1 Ekspert i Legjislacionit për Aktivitetin 3.2.1 Vlerësimi i zbatimit të ligjeve, i forcuar
Titulli i Projektit	Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST)
Referenca	EuropeAid/166090/DD/ACT/XK
Përmbajtja e detyrës	Ofrimi i ekspertizës së sofistikuar ligjore për MD dhe KGJK për çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e zbatimit të kornizës ligjore dhe rregullative, dhe reformimin e kornizës institucionale dhe ligjore të drejtësisë administrative
Kategoria e ekspertit	Ekspert Vendor Afatmesëm (EVAM)
Kohëzgjatja e detyrës	83 ditë (fushëveprimi dhe numri i ditëve të punës për këtë detyrë mund të rritet / zgjatet deri në gjithsej 160 ditë, varësisht nga ecuria e punës, nevojat e projektit dhe miratimi i zyrës së BE-së në Prishtinë)

1. Përshkrimi i detyrës

Objektivat specifike

Kosova ka një kornizë të fortë ligjore, sipas raporteve të njohura vendore dhe ndërkombëtare, megjithatë ka ende probleme me ekzekutim. Siç theksohet nga raportet e besueshme kombëtare dhe ndërkombëtare, Kosova ka një kornizë të fortë ligjore, por në të njëjtën kohë përballet me probleme në zbatim e kësaj kornize. Ka pasur zhvillime në lidhje me aktet nën-ligjore dhe udhëzimet që lehtësojnë monitorimin ex-post të legjislacionit, të cilat tani duhet të vihen në praktikë. Monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator mbetet një sfidë për institucione të ndryshme.

Aktivitetet e parashikuara në këto TR i referohen Objektivës Specifike 3 (Konsolidimi i mëtejshëm dhe bashkërendimi i kornizës ligjore dhe institucionale me legjislacionin, standardet dhe praktikat evropiane si dhe përmirësimi i zbatimit të ligjeve), rezultati 3.2: Forcimi i monitorimit të zbatimit të ligjeve.

Përmes këtij Objektivë, EUKOJUST përpiqet të përmirësojë sistemin e përgjithshëm të vlerësimit të zbatimit të kornizës ligjore dhe rregullative si dhe praktikat aktuale se si kryhet vlerësimi i zbatimit. Gjithashtu, qëllimi është që t'iu ofrohet ndihmë përpjekjeve të institucioneve për ta reformuar drejtësinë administrative.



Gjatë këtij viti, EUKOJUST planifikon të mbështesë Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe Këshillin Gjqësor të Kosovës (KGJK) për të forcuar politikat dhe praktikat e tyre të monitorimit/vlerësimi të kornizës ligjore dhe rregullative brenda fushave të tyre përkatëse. Vlerësimet e ndikimeve janë esenciale për institucionet e Kosovës, të cila përpiqen t'i dizajnojnë dhe vlerësojnë politikat dhe ligjet që të mund t'i arrijnë objektivat e tyre në mënyrë sa më efikase dhe sa më efektive.

EVAM do të ndihmojë Kuvendin e Kosovës në kryerjen e një rishikimi gjithëpërfshirës të normave dhe procedurave të brendshme të Kuvendit të Kosovës në lidhje me mbikëqyrjen legislative, si dhe do të ndihmojë Komisionin Legjislativ të Kuvendit të Kosovës në forcimin e kapaciteteve teknike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së projektligjeve.

EVAM gjithashtu do të mbështesë Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit në zbatimin e Udhëzuesit të Ri për vlerësimin ex-post të ligjeve dhe temave që lidhen me Udhëzuesin.

EVAM do të ndihmojë MD-në në përgatitjen e legjislacionit parësor dhe dytësor në kuadër të portofolit të kompetencave të tij dhe do të monitorojë zbatimin e ligjeve të sponsorizuara nga MD-ja. Po ashtu, do t'i ofrojë ndihmë KGJK-së në lidhje me monitorimin e zbatimit të kornizës së saj rregullative dhe ligjore, si dhe do të ofrojë ndihmë teknike për hartimin e legjislacionit dytësor për të mundësuar zbatim adekuat të legjislacionit.

b) Shërbimet e kërkuara

Shërbimet mund t'i nënshtrohen rishikimit dhe ndryshimeve sipas zhvillimeve të projektit
Eksperti Vendor Afatmesëm 1 sipas këtyre TR-ve do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

- T'i ofrojë mbështetje praktike MD-së në pilotimin e monitorimit të zbatimit të ligjeve sipas Manualit të ri për vlerësimin ex-post të legjislacionit (afërsisht 8 ditë pune)
- Të mbledh informacione përmes vizitave me aktorët kryesorë përgjegjës për monitorimin e ligjeve (afërsisht 5 ditë pune)
- Të identifikojë ligjet kryesore për vlerësimin ex-post dhe të hartojë memorandume me aspekte kyçe përkatëse të një vlerësimi të tillë (afërsisht 6 ditë pune)
- Të ofrojë ndihmë teknike lidhur me vlerësimin e planifikuar ex-post të ligjeve nga MD (afërsisht 6 ditë pune)
- Të kryej një vlerësim të përgjithshëm të nevojave për të rishikuar politikat, strukturat dhe praktikat aktuale për monitorimin e kornizës ligjore dhe rregullative brenda Këshillit Gjqësor të Kosovës.
Duke vepruar kështu, EVAM:

- Do të mbajë fokus grupe dhe takime me përfaqësuesit e KGJK-së për të identifikuar fushat kryesore të kornizës ligjore për rishikim (përafërsisht 3 ditë pune)
- Do të kryej rishikimin e kornizës ligjore dhe rregullative (afërsisht 7 ditë pune)
- Do të kryej mbledhjen e informacionit dhe përfshijë komentet nga Zyra Ligjore brenda KGJK-së (përafërsisht 5 ditë pune)



- Do të ofrojë mbështetje praktike dhe teknike për KGJK-në në hartimin ligjor të akteve që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të Këshillit për të monitoruar kornizën e tij ligjore dhe rregullative (afërsisht 8 ditë pune)
- Të mbështesë Grupet Punuese në përgatitjen e Koncept Dokumenti për kryerjen e Reformës në Drejtësi Administrative (afërsisht 8 ditë pune)
- Të ofrojë komente me shkrim për Koncept Dokumentin për Reformën në Drejtësi Administrative (afërsisht 7 ditë pune)
- Të marrë pjesë në takimet e GP për Projektligjin që do të synojë materializimin e Reformës në Drejtësi Administrative (afërsisht 10 ditë pune)
- Të ofrojë komente me shkrim (udhëzime dhe propozime konkrete) për Koncept Dokumentin për Reformën në Drejtësi Administrative (përafërsisht 10 ditë pune)

c) Produktet

Produktet që do t'i realizojë EVAM janë si në vijim :

- Me kërkesë të MD-së, hartimi i raporteve dhe memorandumeve ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me monitorimin e ligjeve të sponsorizuara nga MD (afërsisht 10 ditë pune),
- Hartimi i raportit(eve) për monitorimin e zbatimit të ligjit(eve) sipas standardit që është i aplikueshëm në përdorim zyrtar (afërsisht 15 ditë pune), që do të ndahet si më poshtë:
 - Komente me shkrim për monitorimin e ligjit nr. 1 (të specifikohet pas fillimit të angazhimit), (afërsisht 5 ditë pune)
 - Komente me shkrim për monitorimin e ligjit nr. 2 (që do të specifikohet pas fillimit të angazhimit), (afërsisht 5 ditë pune)
 - Komente me shkrim për monitorimin e ligjit nr. 1 (që do të specifikohet pas fillimit të angazhimit), (afërsisht 5 ditë pune)
- Raport mbi vlerësimin e përgjithshëm të nevojave për të rishikuar politikat, strukturat dhe praktikat aktuale për monitorimin e kornizës ligjore dhe rregullative në kuadër të KGJK-së (afërsisht 7 ditë pune), që do të ndahet si në vijim :
 - Raport mbi fokus grupet dhe takimet me përfaqësuesit e KGJK-së për të identifikuar fushat kryesore të kornizës ligjore për rishikim (afërsisht 4 ditë pune)
 - Të dhëna me shkrim pas rishikimit të kornizës ligjore dhe rregullative (afërsisht 3 ditë pune)
- Hartimi i raporteve adekuate që pasqyrojnë nivelin e zbatimit, si dhe rekomandimet e ligjeve të monitoruara (afërsisht 10 ditë pune)
- Komente me shkrim dhe mbështetje tjetër teknike për KGJK-në në hartimin ligjor të akteve që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të Këshillit për të monitoruar kornizën e tij ligjore dhe rregullative (afërsisht 6 ditë pune)
- Analiza ligjore, raporte, komente me shkrim dhe rezultate të tjera që rezultojnë dhe mbështetja praktike e ofruar për KGJK-në, përmes analizave dhe hartimit ligjor të akteve që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të Këshillit për të monitoruar kornizën e tij ligjore dhe rregullative (afërsisht 18 ditë pune), do të ndahen si më poshtë:



- Raportet nga takimet me fokus grupet dhe takimet me përfaqësuesit e KGJK-së për të identifikuar fushat kryesore të kornizës ligjore për shqyrtim (afërsisht 3 ditë pune)
- Memorandumi i ardhur nga rishikimi i kornizës ligjore dhe rregullative (afërsisht 8 ditë pune)
- Komente me shkrim dhe mbështetje tjetër praktike dhe teknike për KGJK-në në hartimin ligjor të akteve të veta që kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve të KGJK-së dhe përmbushjen e detyrave të saja kushtetuese dhe ligjore (afërsisht 7 ditë pune)
- Raporte, analiza dhe të dhëna të tjera me shkrim në kuadër të mbështetjes së reformës në drejtësinë administrative (afërsisht 17 ditë pune), të ndara si më poshtë:
 - Raporte nga pjesëmarrja në takimet e GP për Koncept Dokumentin për Reformën në Drejtësi Administrative (afërsisht 4 ditë pune)
 - Mbështetje teknike përmes ekspertizës ligjore për standardet më të mira evropiane lidhur me Koncept Dokumentin për Reformën në Drejtësi Administrative (afërsisht 6 ditë pune)
 - Raporte dhe analiza ligjore nga pjesëmarrja në mbledhjet e GP për Projektligjin që do të synojë materializimin e Reformës në Drejtësi Administrative (afërsisht 4 ditë pune)
 - Ofrimi i komenteve shtesë me shkrim dhe memorandumit për të mbështetur MD-në dhe KGJK-në në procesin e përfundimit të reformës së drejtësisë administrative (afërsisht 3 ditë pune)

d) Raportimi

EVAM do të ofrojë raporte të rregullta mujore të misionit të tij/saj, jo më vonë se 1 javë pas përfundimit të çdo muaji të punuar duke përdorur shabllonet e Projektit. Këto raporte do të përfshijnë një përshkrim të të gjitha aktiviteteve dhe rezultateve të ofruara nga EVAM në kontekstin e kësaj detyre.

2. Kontributi i ekspertit

Gjithsej ditë pune	83 ditë (fushëveprimi dhe numri i ditëve të punës për këtë detyrë mund të rritet / zgjatet deri në gjithsej 160 ditë, varësisht nga ecuria e punës, nevojat e projektit dhe miratimi i zyrës së BE-së në Prishtinë)
Periudha e detyrës	Pritet që puna të kryhet nga maji 2022 e në vazhdim. Megjithatë, data e saktë e fillimit do të bihet dakord në një fazë të mëvonshme
Dita e fillimit	Maj 2022
Vendndodhja e detyrës	Prishtinë, Kosovë
Gjuha e punës	Gjuha angleze
Kontrata	Kontratë e shërbimeve
Kompensimi	Tarifë prej 150 euro/ditë



3. Profili i ekspertit/kualifikimet e kërkuara

Kualifikimi dhe shkathtësitë	<ul style="list-style-type: none">• Fakulteti juridik• Njohuri e shkëlqyer e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar• Aftësi të shkëlqyera ndër-personale dhe komunikuese duke përfshirë përvojën në kryerjen e vlerësimeve të mangësive, vlerësimit institucional dhe ngritjes së kapaciteteve• Përvojë e lartë menaxheriale dhe planifikimit në sektorin e sundimit të ligjit• Njohuri të shkëlqyera kompjuterike (aplikacionet e MS Office)
Përvoja e përgjithshme profesionale	<ul style="list-style-type: none">• Të paktën 8 vjet përvojë të përgjithshme profesionale
Përvoja specifike profesionale	<ul style="list-style-type: none">• Të paktën 4 vjet përvojë relevante në institucionet e sektorit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë• Përvojë e demonstruar në ofrimin e asistencës teknike në projektet e zhvillimit parlamentar• Njohuri e dëshmuar e nevojave, mangësive dhe sfidave legislative të Kosovës• Përvojë e dëshmuar në publikimet ligjore dhe analizën e mangësive legislative• Përvojë e fortë në hartimin ligjor, analizën ligjore dhe rishikimin legjislativ, mundësisht me të paktën një nga institucionet përfituese• Përvojë dhe njohuri të demonstruara për të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe standardet gjyqësore



LOT 2: Ekspert Vendor Afatmesëm 4

Asistenca teknike e kërkuar:	Ekspert Afatmesëm Vendor 4 për TIK për aktivitetin 2.3.3 Mbështetje për infrastrukturën e TI-së për gjykatoret dhe sallat e prokurorive
Titulli i projektit:	Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST)
Referenca:	EuropeAid/166090/DD/ACT/XK
Përmbajtja e detyrës:	Ofrimi i ekspertizës së TIK-ut për KGJK-në dhe KPK-në për përmirësimin e Qendrës së të Dhënave, sigurinë e sistemeve të të dhënave dhe zhvillimin e protokolleve dhe procedurave standarde të operimit
Kategoria e ekspertit	Ekspert Vendor Afatmesëm (EVAM)
Kohëzgjatja e detyrës	Gjithsej 100 ditë, në varësi të nevojave të projektit dhe aprovimit të Zyrës së BE-së në Prishtinë.

1. Përshkrimi i detyrës

a) Objektivat specifike

Aktivitetet e parashikuara në këto TR rrjedhin nga Objektivi Specifik 2.3: Përmirësimi i Infrastrukturës Gjyqësore, veçanërisht lidhur me mirëmbajtjen efikase të infrastrukturës ekzistuese të TIK-ut dhe zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve të gjykatoreve.

EVAM do të angazhohet dhe do të ofrojë ekspertizë teknike inovative të TIK-ut në drejtim të skanimit dhe hartëzimit të dobësive në infrastrukturën e TIK-ut të gjykatave dhe prokurorive, do të propozojë dhe zhvillojë udhëzime të orientuara drejt zgjidhjeve, procedura standarde të operimit dhe dokumente strategjike në funksion të forcimit të sigurisë së sistemeve dhe bazave të të dhënave të TIK-ut, do të prezantojë, përmirësojë dhe institucionalizojë zbatimin e zgjidhjeve të TIK-ut.

EVAM, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse të TI-së të KGJK-së dhe KPK-së, pritet të hartojë një analizë të detajuar të qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë për të vlerësuar boshllëqet dhe për të propozuar ndërhyrje për të ngritur dhe përmirësuar funksionimin e përgjithshëm të qendrës së të dhënave. Kjo analizë duhet të përfshijë nivelin e sigurisë së informacionit të qendrës së të dhënave.

Ndërlidhja dhe interoperabiliteti i sistemeve të të dhënave në gjykata dhe prokurori dhe shkëmbimi i komunikimit me institucionet e tjera të sektorit të drejtësisë është thelbësor për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së sektorit të drejtësisë. EVAM do të hartojë një analizë për të paraqitur veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren për të forcuar ndërlidhjen dhe interoperabilitetin e sistemeve të të dhënave.

Mirëmbajtja e sistemeve ekzistuese të TIK-ut në gjykata dhe prokurori është sfiduese dhe kërkon vazhdimisht aplikimin e praktikave inovative të punës dhe zbatimin e aplikacioneve të reja softuerike. EVAM



pritet të hartojë procedura standarde të qarta dhe të detajuara të operimit për t'i mirëmbajtur, zhvilluar më tej dhe përmirësuar sistemet softuerike.

b) Shërbimet e kërkuara

Shërbimet mund të rishikohen dhe ndryshohen sipas zhvillimeve të projektit.

Eksperti Vendor Afatmesëm 4 sipas këtyre TR-ve do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

- I. Analizë e gjerë e boshllëqeve të qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë; do t'i trajtojë me përpikëri fushat ku nevojitet ndërhyrja për të ngritur dhe përmirësuar funksionalitetet e mëtejshme të qendrës së të dhënave. EVAM duhet të nxjerrë rekomandime dhe sugjerime pragmatike dhe praktike që do të kontribuonin në përmirësimin e përgjithshëm të qendrës së të dhënave.
 - Vizita në terren në qendrën e të dhënave, gjykata, prokurori, KGJK dhe KPK dhe takime me zyrtarët aktualë të cilët janë në gjendje të ndajnë informacione mbi praktikën ekzistuese dhe të eksplorojnë rrugët për zhvillimin e zgjidhjeve digjitale që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së gjykatave dhe prokurorive.
 - EVAM, në koordinim me Ekspertët Afatgjatë, pritet të vizitojë institucionet homologe për të vlerësuar nga afër aspektet teknike të qendrës së të dhënave. Pas vizitave dhe takimeve me zyrtarët përkatës, EVAM do të përcaktojë në detaje se cilat veprime duhet të ndërmerren.
 - Do të hartojë një analizë gjithëpërfshirëse të boshllëqeve dhe të japë rekomandime për ndërhyrje dhe përmirësim.
 - EVAM duhet të prezantojë vazhdimisht gjetjet dhe të diskutojë zgjidhjet me përfaqësuesit e KGJK-së dhe KPK-së për të siguruar kontributin efektiv nga bashkëbiseduesit përkatës.
 - Do të zhvillojë protokollet e sigurisë kibernetike/procedurat standarde të funksionimit për KGJK-në dhe KPK-në. EVAM do të mbështesë departamentet përkatëse të TI-së të KGJK-së dhe KPK-së për hartimin e protokolleve të sigurisë kibernetike për të siguruar një përgjigje uniforme për situatat e pasigurta të TIK-ut.
 - EVAM pritet të hartojë procedura standarde të qarta dhe të detajuara të operimit për t'i mirëmbajtur, zhvilluar më tej dhe përmirësuar sistemet softuerike.

c) Produktet

EVAM do të realizojë produktet në vijim:

- I. Analiza e boshllëqeve në Qendrën e të Dhënave të Pallatit të Drejtësisë (30 faqe), e cila duhet të përfshijë të paktën komponentët e mëposhtëm:
 - Përmbledhje ekzekutive (1 ditë pune)
 - Hyrje (1 ditë pune)
 - Përshkrim i metodologjisë së vlerësimit (1 ditë pune)
 - Analizë e situatës në lidhje me caqet dhe rezultatet e pritura, praktikën e institucioneve përkatëse (5 ditë pune)
 - Gjetjet kryesore sipas seksionit "b." të këtyre TR-ve, (1 ditë pune)
 - Përfundime dhe rekomandime (1 ditë pune).



- Takime me Departamentin e TI-së të KGJK-së dhe stafin e TI-së në Pallatin e Drejtësisë (përafërsisht 4 ditë pune).
 - Takime me Departamentin e TI-së të KPK-së (përafërsisht 3 ditë pune).
 - Vizitë në gjykata, prokurori, KGJK dhe KPK (përafërsisht 3 ditë pune).
 - Vizitë në prokurori dhe KPK (përafërsisht 2 ditë pune).
 - Lehtësimi i një fokus grupi të pjesëmarrësve nga stafi i TI-së nga KGJK dhe Pallati i Drejtësisë (gjykatat) (përafërsisht 3 ditë pune).
 - Lehtësimi i një fokus grupi të pjesëmarrësve nga stafi i TI-së nga KPK dhe Pallati i Drejtësisë (prokuroria) (përafërsisht 2 ditë pune).
- II. Mbështet KPK-në dhe KGJK-në në hartimin e protokolleve të sigurisë kibernetike – (40 faqe, përafërsisht 15 ditë pune).
- Lehtësimi i dy sesioneve të takimeve të fokus grupit me stafin e TI-së të KGJK-së për protokollet e sigurisë kibernetike (rreth 3 ditë pune).
 - Lehtësimi i dy takimeve të fokus grupit me stafin e TI-së të KPK-së mbi protokollet e sigurisë kibernetike (rreth 3 ditë pune).
 - Ofrimi i një sërë trajnimesh për stafin e TI-së të KGJK-së dhe gjykatave për sigurinë e sistemeve, shkëmbimin e sigurt të të dhënave dhe mirëmbajtjen e platformave të ndryshme të TIK-ut (rreth 5 ditë pune).
 - Ofrimi i një sërë trajnimesh për stafin e TI-së të KPK-së dhe gjykatave për sigurinë e sistemeve, shkëmbimin e sigurt të të dhënave dhe mirëmbajtjen e platformave të ndryshme të TIK-ut (rreth 5 ditë pune).
- III. Hartimi i procedurave standarde të operimit të qarta dhe të detajuara për t'i mirëmbajtur, zhvilluar më tej dhe përmirësuar sistemet softuerike (13 ditë pune), të cilat duhet të përfshijnë të paktën komponentët e mëposhtëm:
- Përmbledhje ekzekutive
 - Hyrje
 - Përshkrim i metodologjisë së vlerësimit
 - Analizë e situatës në lidhje me caqet dhe rezultatet e pritura, praktikat e institucioneve përkatëse
 - Gjetjet kryesore sipas pjesës “b.” të këtyre TR-ve,
 - Përfundime dhe rekomandime.
- Takime me zhvilluesit e TI-së të KGJK-së dhe gjykatave (përafërsisht 2 ditë pune).
 - Takime me zhvilluesit e TI-së të KPK-së dhe prokurorisë (përafërsisht 2 ditë pune).
 - Një punëtori me stafin e TI-së të KGJK-së dhe gjykatave për të diskutuar dhe finalizuar PSO-të (përafërsisht 3 ditë pune).
 - Një punëtori me stafin e TI-së të KPK-së dhe prokurorisë për të diskutuar dhe finalizuar PSO-të (përafërsisht 2 ditë pune).
 - Komente përfundimtare të inkuorporuara në dokumentet e PSO-ve (përafërsisht 2 ditë pune).
- IV. Ofrimi i trajnimeve:
- Trajnime praktike me zhvilluesit e TI-së nga KGJK-ja dhe gjykatat (përafërsisht 6 ditë pune).
 - Trajnime praktike me zhvilluesit e TI-së të KPK-së dhe prokurorisë (përafërsisht 6 ditë pune).



- Zhvillon kurrikula dhe materiale të trajnimit të përshtatura posaçërisht për zhvillimin e softuerit të TI-së për KGJK-në dhe gjykatat (përafërsisht 3 ditë pune).
- Zhvillon kurrikula dhe materiale të trajnimit të përshtatura posaçërisht për zhvillimin e softuerit të TI-së për KPK dhe shërbimin e prokurorisë (përafërsisht 3 ditë pune).

d) Raportimi

EVAM do të sigurojë raporte të rregullta mujore të misionit, jo më vonë se 1 javë pas përfundimit të çdo muaji të punuar duke përdorur shabllonet e projektit. Këto raporte do të përfshijnë përshkrimin e të gjitha aktiviteteve dhe produkteve të ofruara nga EVAM në kontekstin e kësaj detyre.

2. Kontributi i ekspertit

Gjithsej ditë pune	Për këtë detyrë janë planifikuar 100 ditë, në varësi të nevojave të projektit.
Periudha e detyrës	1 maj 2022 – 31 janar 2024
Dita e fillimit	Pritet që puna të kryhet nga maji 2022 e në vazhdim. Megjithatë, data e saktë e fillimit do të bihet dakord në një fazë të mëvonshme.
Vendndodhja e detyrës	Prishtinë, Kosovë
Gjuha e punës	Gjuha angleze
Kontrata	Kontratë e shërbimeve
Kompensimi	Tarifë prej 150 euro/ditë

3. Profili i ekspertit/Kualifikimet e kërkuara

Kualifikimi dhe shkathtësitë	<ul style="list-style-type: none"> • Diplomë akademike në shkencat teknike, matematikë ose shkenca kompjuterike • Njohuri e shkëlqyer e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar. • Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese duke përfshirë përvojën në kryerjen e vlerësimeve të mangësive të TI-së, vlerësimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të TI-së. • Përvojë e lartë menaxheriale dhe planifikimit në sektorin e sundimit të ligjit. • Njohuri të shkëlqyera kompjuterike (aplikacionet e MS Office)
Përvoja e përgjithshme profesionale	<ul style="list-style-type: none"> • Të paktën 8 vjet përvojë të përgjithshme profesionale



<p>Përvoja specifike profesionale</p>	<ul style="list-style-type: none">• Së paku 4 vjet përvojë TI në sektorin e Drejtësisë dhe Sundimit të Ligjit;• Përvojë me të paktën dy projekte të zhvillimit të sistemit të menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive, inteligjencës dhe statistikave të biznesit për sektorin e drejtësisë, automatizimi i proceseve të biznesit të gjykatave dhe prokurorive.
---------------------------------------	--





LOT 3: Ekspert Vendor Afatmesëm 5

Asistenca teknike e kërkuar:	Ekspert Vendor Afatmesëm 5 për TIK-un në gjykatore për Aktivitetin 2.3.1 Mbështetje për tenderimin e infrastrukturës fizike së gjykatoreve dhe prokurorive
Titulli i projektit:	Programi i BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST)
Referenca:	EuropeAid/166090/DD/ACT/XK
Përmbajtja e detyrës:	Ofrimi i ekspertizës së TIK-ut për KGJK-në dhe KPK-në për digjitalizimin e gjykatave dhe prokurorive
Kategoria e ekspertit	Ekspert Vendor Afatmesëm (EVAM)
Kohëzgjatja e detyrës	Gjithsej 100 ditë, në varësi të nevojave të projektit dhe aprovimit të Zyrës së BE-së në Prishtinë.

1. Përshkrimi i detyrës

a) Objektiva specifike

Aktivitetet e parashikuara në këto TR rrjedhin nga Objektiva Specifike 2.3: Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore, veçanërisht lidhur me mirëmbajtjen efikase të infrastrukturës ekzistuese të TIK-ut dhe zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve të gjykatoreve.

EVAM do të angazhohet dhe do të ofrojë ekspertizë teknike inovative të TIK-ut në drejtim të skanimit dhe hartëzimit të dobësive në infrastrukturën e TIK-ut të gjykatave dhe prokurorive, do të propozojë dhe zhvillojë udhëzime të orientuara drejt zgjidhjeve, procedura standarde të operimit dhe dokumente strategjike në funksion të zbatimit të zgjidhjeve në TIK.

EVAM, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me departamentet përkatëse të TI-së të KGJK-së dhe KPK-së, pritet të përcaktojë procedurat në gjykatore për zgjidhjet e mundshme të TIK-ut duke marrë parasysh digjitalizimin ose automatizimin e mëtejshëm të proceseve ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive për të dhënë drejtësi. Futja pa probleme dhe e qëndrueshme e zgjidhjeve të mbështetura nga TIK-u në procedurat e sallës së gjyqit duhet të shoqërohet me ndryshimet e nevojshme ligjore dhe rregullatore, prandaj, EVAM do të duhet t'i harmonizojë aktivitetet me LTE për Infrastrukturën Gjyqësore dhe departamentet përkatëse në KPK-së dhe KGJK-së.

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) në gjykata dhe prokurori, krahas protokolleve të qarta për të siguruar mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e tij, kërkon zhvillim të mëtejshëm për t'u



larguar nga puna me dokumente në kopje fizike dhe për t'i përqafuar risitë e TIK-ut me qëllimin e përgjithshëm për t'i bërë gjykatat dhe prokuroritë më shumë efektive, transparente dhe të përgjegjshme. Në këtë drejtim, EVAM do të ofrojë mbështetje të vlefshme ekspertize të TIK-ut në hartimin/ndryshimin e kornizës rregullative të SMIL-it, Planeve Strategjike të TIK-ut për KGJK-në dhe KPK-në, Raportit të Vlerësimit dhe Udhëzimeve për Departamentin e TI-së të KGJK-së.

b) Shërbimet e kërkuara

Shërbimet mund të rishikohen dhe ndryshohen sipas zhvillimeve të projektit.

Eksperti Vendor Afatmesëm 5 sipas këtyre TR-ve do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

- I. Hartëzimi i gjerë dhe i bazuar në dëshmi i zgjidhjeve të TIK-ut në sallën e gjyqit dhe propozimi i zgjidhjeve teknike të zbatueshme në përputhje me praktikatat më të mira të TIK-ut që janë në zhvillim e sipër. Avancimi i zgjidhjeve pragmatike të mbështetura sipas teknologjisë dhe duke marrë parasysh efikasitetin dhe qasjen miqësore për përdoruesit.
 - Vizita në terren në gjykata, prokurori, KGJK dhe KPK dhe takime me zyrtarë aktualë të cilët janë në gjendje të ndajnë informacione mbi praktikatat ekzistuese dhe të eksplorojnë rrugët për zhvillimin e zgjidhjeve digjitale që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së gjykatave dhe prokurorive.
 - EVAM, në koordinim me Ekspertët Afatgjatë, pritet t'i vizitojë institucionet homologe për t'i vlerësuar nga afër aspektet teknike të infrastrukturës aktuale të TIK-ut në sallën e gjyqit. Pas vizitave dhe takimeve me zyrtarët përkatës, EVAM do të përcaktojë në detaje se cilat veprime duhet të ndërmerren për prezantimin e zgjidhjeve të reja teknologjike.
 - Hartimi i një raporti gjithëpërfshirës të hartëzimit për TIK-un në sallën e gjyqit dhe ofrimi i rekomandimeve për ndërhyrje dhe përmirësime.
 - Raporti i hartëzimit duhet të nxjerrë në pah në mënyrë të përpiktë dhe sistematike praktikatat e rënda që pengojnë një efikasitet më të mirë në kuptimin e kryerjes së procedurave ligjore në gjykata dhe prokurori. EVAM duhet të hartojë në mënyrë pragmatike rekomandime për fusha specifike për të ndërhyrë dhe për të propozuar mjete dhe veprime të nevojshme drejt digjitalizimit dhe automatizimit më të mirë të procedurave në sallën e gjyqit.
 - EVAM duhet të prezantojë vazhdimisht gjetjet dhe të diskutojë zgjidhjet me përfaqësuesit e KGJK-së dhe KPK-së për të siguruar kontributin efektiv nga bashkëbiseduesit përkatës.
- II. Hartimi i një raporti vlerësimi për punën e Departamentit të TI-së të KGJK-së dhe hartimi i udhëzimeve dhe protokolleve për të përmirësuar punën e këtij departamenti.

c) Produktet

EVAM do të realizojë produktet në vijim:



- Hartëzimi i TIK-ut në sallën e gjyqit (**40** faqe), që duhet të përfshijë të paktën komponentët e mëposhtëm:
 - Përmbledhje ekzekutive (1 ditë pune)
 - Hyrje (1 ditë pune)
 - Përshkrim i metodologjisë së vlerësimit (2 ditë pune)
 - Analizë e situatës në lidhje me caqet dhe rezultatet e pritura, praktikatat e institucioneve përkatëse (5 ditë pune)
 - Gjetjet kryesore sipas pjesës "b." të këtyre TR-ve (1 ditë pune)
 - Përfundime dhe rekomandime (2 ditë pune).
- Vizita në terren dhe takime me KGJK-në dhe me zyrtarët aktualë të gjykatave (përafërsisht 5 ditë pune).
- Vizita në terren dhe takime me zyrtarët aktualë të KPK-së dhe të prokurorisë (përafërsisht 5 ditë pune).
- I ofron KGJK-së mbështetje ekspertize në planin e saj strategjik të parashikuar për TIK-un. (përafërsisht 5 ditë pune).
- Merr pjesë dhe kontribuon në punëtoritë/grupet punuese të udhëhequra nga KGJK-ja për hartimin e Planit Strategjik të TIK-ut (përafërsisht 5 ditë pune).
- I ofron ekspertizë KPK-së në planin e saj strategjik të parashikuar të TIK-ut. (përafërsisht 5 ditë pune).
- Merr pjesë dhe kontribuon në punëtoritë/grupet punuese të udhëhequra nga KPK-ja për hartimin e Planit Strategjik të TIK-ut (përafërsisht 5 ditë pune).
- Mbështet KPK-në dhe KGJK-në për të hartuar një udhëzues për futjen e nënshkrimeve elektronike në sallën e gjyqit dhe procedurat e prokurorive (40 faqe), e cila duhet të përfshijë së paku komponentët e mëposhtëm:
 - Përmbledhje ekzekutive (1 ditë pune)
 - Hyrje (1 ditë pune)
 - Përshkrimi i metodologjisë së vlerësimit (2 ditë pune)
 - Analiza e gjendjes në lidhje me objektivat dhe rezultatet e pritshme, praktikatat e institucioneve përkatëse (8 ditë pune)
 - Gjetjet kryesore sipas seksionit "b". i këtij TR (1 ditë pune)
 - Konkluzione dhe rekomandime (2 ditë pune).
- Lehtësimi i dy sesioneve të takimeve të fokus grupit me stafin e TI-së të KGJK-së për udhëzues/analiza (përafërsisht 3 ditë pune).
- Lehtësimi i dy sesioneve të takimeve të fokus grupit me stafin e TI-së të KPK-së për udhëzues/analiza (përafërsisht 3 ditë pune).
- Hartimi i protokolleve për mënyrën e përdorimit të nënshkrimeve elektronike në proceset gjyqësore në gjykata (përafërsisht 5 ditë pune).
- Hartimi i protokolleve për mënyrën e përdorimit të nënshkrimeve elektronike në procedurat ligjore në prokurori (përafërsisht 5 ditë pune).
- Mbështet KGJK-në në ndryshimin e Rregullores për SMIL-in (draft raporti i ekspertit 20 faqe, përafërsisht 5 ditë pune).



- Merr pjesë dhe ofron kontributin e tij/saj në punëtoritë e udhëhequra nga KGJK-ja për hartimin e Rregullores për SMIL-in (përafërsisht 3 ditë pune).
- Harton një raport vlerësimi për punën e Departamentit të TI-së të KGJK-së dhe harton udhëzime dhe protokolle për punën e këtij departamenti (udhëzime dhe plane 40 faqe, përafërsisht 9 ditë pune).
- Lehtëson dy sesione të takimit të fokus grupit me departamentin e TI-së të KGJK-së për t'i diskutuar gjetjet dhe rezultatet e raportit të vlerësimit të Departamentit të TI-së të KGJK-së (përafërsisht 5 ditë pune).
- Lehtëson dy sesione për grupin punues për t'i diskutuar dhe finalizuar udhëzimet dhe protokollat (përafërsisht 5 ditë pune).

d. Raportimi

EVAM do të sigurojë raporte të rregullta mujore të misionit, jo më vonë se 1 javë pas përfundimit të çdo muaji të punuar duke përdorur shabllonet e projektit. Këto raporte do të përfshijnë përshkrimin e të gjitha aktiviteteve dhe produkteve të ofruara nga EVAM në kontekstin e kësaj detyre.

2. Kontributi i ekspertit

Gjithsej ditë pune	Për këtë detyrë janë planifikuar 100 ditë, në varësi të nevojave të projektit.
Periudha e detyrës	1 maj 2022 – 31 janar 2024
Dita e fillimit:	Pritet që puna të kryhet nga maji 2022 e në vazhdim. Megjithatë, data e saktë e fillimit do të bihet dakord në një fazë të mëvonshme.
Vendndodhja e detyrës	Pristina, Kosovo
Gjuha e punës	Gjuha angleze
Kontrata	Kontratë e shërbimeve
Kompensimi	Tarifë prej 150 euro/ditë

3. Profili i ekspertit/Kualifikimet e kërkuara

Kualifikimi dhe shkathtësitë	<ul style="list-style-type: none"> • Diplomë akademike në shkencat teknike, matematikë ose shkenca kompjuterike • Njohuri e shkëlqyer e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar. • Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese duke përfshirë përvojën në kryerjen e vlerësimeve të mangësive të TI-së, vlerësimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të TI-së.
------------------------------	---



	<ul style="list-style-type: none">• Përvojë e lartë menaxheriale dhe planifikimit në sektorin e sundimit të ligjit.• Njohuri të shkëlqyera kompjuterike (aplikacionet e MS Office)
Përvoja e përgjithshme profesionale	<ul style="list-style-type: none">• Të paktën 8 vjet përvojë të përgjithshme profesionale
Përvoja specifike profesionale	<ul style="list-style-type: none">• Së paku 4 vite përvojë TI në sektorin e Drejtësisë dhe Sundimit të Ligjit• Përvojë me të paktën dy projekte të zhvillimit të sistemit të menaxhimit të gjykatave dhe prokurorive, inteligjencës dhe statistikave të biznesit për sektorin e drejtësisë, automatizimi i proceseve të biznesit të gjykatave dhe prokurorive.• Përvojë e lartë në lidhje me hartimin/ndryshimin e kornizës rregullative të SMIL-it, Planeve Strategjike të TIK-ut për KGJK-në dhe KPK-në

Ju lutemi që për detaje të mëtejme mbi mbrojtjen e të dhënave dhe mënyrën se si Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) përpunon të dhënat tuaja personale dhe çfarë të drejta u takojnë sipas ligjit të privatësisë së të dhënave t'i referoheni vegëzës në vijim:
<https://www.irz.de/index.php/en/data-privacy-notice-en>